

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Më vjen turp...", kreu i Unionit të Gjyqtarëve: Ligji duhet të kthehet, kemi gati materialin
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/me-vjen-turp-kreu-i-unionit-te-gjyqtareve-ligji-duhet-te-kthehet-kemi-g-i586304
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:05:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:05:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	58691e3f7dbed707a736f262f359955a458aee4155fa213bef61b0b1f69993c3
TEKSTI	c2f1203564bf8fa4baf61cc1d22b312094f4b6f451d3a1784f0960f849af2cc0
PAMJA	befb043e376ce1918904425737d1abf96394606a394595a6735c4e1ab0aeda3b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d10c3e124232c144b259cc7b4b896699311fe25305d4287fa91e6d2b0635f840
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d10c3e124232c144b259cc7b4b896699311fe25305d4287fa91e6d2b0635f840>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)



English



ie ["Me vjen turp...", kreu i Unionit të Gjyqtareve: Ligji duhet të kthehet, kemi gati materialin VIDEO/ Situata e sikletshme, atletja australiane peson diarre gjate gares dhe shk fundit](#)

"Më vjen turp...", kreu i Unionit të Gjyqtarëve: Ligji duhet të kthehet, kemi gati materialin



15 Shtator 2026, 17:05Politika TEMA



Në Komisionin e Ligjeve u zhvilluan këtë të martë dëgjesa me krerët e institucioneve të drejtësisë, të cilët kundërshtuan formulën e propozuar nga Partia Socialiste për pagat e magistratëve.

Debatu lidhet me ndryshimet e propozuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ku mazhoranca parashikon një rritje prej 5.5% të pagave. Propozimi ka marrë miratimin e Komisionit të Ekonomisë, por është kundërshtuar në Komisionin e Ligjeve nga përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë.

Ngërçi i krijuar rreth pagave dhe formula e propozuar nga PS kanë sjellë debate të forta mes përfaqësuesve të drejtësisë dhe deputetëve të opozitës e mazhorancës.

Kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Mirela Bogdani, e konsideron rritjen e propozuar minimale krahasuar me atë që vetë Këshilli ka përllogaritur për pagat e anëtarëve të tij.

"Rritje minimale krahasuar me atë që përcakton apo ka përllogaritur vetë Këshilli për pagat e anëtarëve të vet. Do të thoja që është një diferencë e madhe."

Edhe përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë u shpreh kundër formulës së propozuar, duke theksuar se problemi nuk qëndron te zgjedhja e një reference nga ligjvënësi, por te rezultati që prodhon formula.

"I qëndrojmë parimit që nuk kundërshtohet mundësia që ligjvënësi të zgjedhë një referencë, por problemi qëndron te rezultati konkret i formulës së propozuar. Ne insistojmë në atë që referenca duhet të lidhet me një pagë e cila rritet herë pas here. Sepse kështu do të ruhet niveli i mbrojtjes financiare të magistratëve."

Më i ashpër në qëndrimin e tij ishte zv/kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe njëkohësisht Kryetar i Unionit të Gjyqtarëve Gerd Hoxha, i cili kritikoi mungesën e konsultimit me gjyqtarët dhe paralajmëroi një përplasje të re mes pushteteve.

"Është i pakonsultuar me grupin, sepse nuk konsultohet ligji tre ditë para se të kalojë në Parlament. Miratimi i këtij ligji do të sjellë një përplasje tjetër mes dy pushteteve. Ne nuk kemi ekskluzivitetin e të drejtës, por ne po respektojmë vendimin e Gjykatës Kushtetuese."

Hoxha theksoi po ashtu se nëse ligji miratohet në këtë formë, magistratët mund t'i drejtohen sërish Gjykatës Kushtetuese, çka, sipas tij, mund të sjellë pasoja

financiare për buxhetin e shtetit.

“Mbi të gjitha, do të sjellë rëndim të buxhetit të shtetit, sepse magjistratët do të shkojnë në Kushtetuese të kërkojnë zbatimin e vendimit dhe gjasat janë, pa bërë profetin, që vendimi do të jetë i njëjtë.”

Ai kërkoi që drafti të rikthehet për konsultim më të gjerë, duke thënë se gjyqtarët kanë edhe një propozim konkret për zgjidhjen e problematikës.

“Ligji i ri duhet të kthehet, t’i nënshtrohet një konsultimi më të gjerë. Mua më vjen turp se unë jam student i profesor Pandës (Ilir Panda), dhe paga ime është më e lartë se paga e tij, ai është anëtar i Gjykatës së Lartë! Ne kemi gati një material që mund ta rregullojë këtë problem.”

Në fund, Hoxha u shpreh se është i gatshëm për dialog me mazhorancën, por theksoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jetë objekt negocimi.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Vendimi i Gjykatës së Lartë për Veliajn, reagon Rama: Kryeqyteti prej thajse dy vitesh jeton me “kokë të prerë”! Kalvar unik në historinë e Europës demokratike

15:30 Politika / 23 komente

Drafti i PS-së për pagat e magjistratëve, KLP: Rritja është minimale, diferenca me përlogaritjen tonë shumë e madhe

14:35 Politika / 4 komente

[Rama fton gjyqtarët në tryezë/ Çupi: Një histori që ka shkaktuar tension në publik, u treguan mizorë me paratë e shqiptarëve](#)

14:25 Politika / 3 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.